REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr 2173 **Prot** **Lushnje me ,** 10 / 03 /**2023**

Lënda: Rezultatet e Sondazhit të Prioriteteve të Komunitetit të Bashkisë Lushnjë
Drejtuar: **Znj. Eriselda Sefa**, Kryetare e Bashkisë

Për dijeni: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Lushnje

E nderuar znj. Kryetare

Komisioni i i Ekonomisë Problemeve Sociale dhe Strehimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi rezultatet e sondazhit të prioriteteve të komunitetit për Projekt-buxhetin Afatmesëm 2024-2026, kërkon reflektimin e prioriteteve kryesore që kanë dalë nga ky sondazh.

Sondazhi i hartuar dhe i organizuar nga Këshilli Bashkiak dhe i publikuar në faqen e Websitit, dhe facebook-un e Bashkisë dhe të Këshillit ka si qëllim të sjellë zërin qytetar dhe të grupeve të interesit pranë pushtetit lokal dhe mundësisht të përfshijë disa nga këto prioritete në buxhetin e vitit të ardhshëm 2024 si pjesë e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026, brenda kapaciteteve fianciare dhe prioriteteve strategjike të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Këshilli i Bashkisë, pasi analizoi rezultatet e sondazhit, vëren se funksionet e përfshira në programet e mëposhtme janë konsideruar prioritare nga shumica e të anketuarve në sondazh:

- *Programi 04130*: Mbështetje për zhvillim ekonomik
- *Programi 04220*: Shërbimet bujqësore
- *Programi 06370*: Furnizimi me ujë dhe kanalizime
- *Programi 06260*: Shërbimet publike vendore dhe ndriçimi

Për sa më sipër, rekomandojmë që gjatë procesit të përgatitjes së tavaneve përgatitore për PBA 2024 – 2026, Bashkia të marrë parasysh dhe të reflektojë rekomandimet e komunitetit, duke planifikuar më shumë fonde për programet prioritare të sipërpërmendura me qëllim përfshirjen e mendimit dhe sugjerimeve qytetare ne hartimin e dokumentave të rëndësishëm financiar të Bashkisë Lushnjë.

Komisioni pret reagimin Tuaj në lidhje me kërkesat e komunitetit përpara se të miratojë draftin e parë të PBA-së në muajin Mars.

Kryetar i Këshillit **Ferdinant Gjermeni**

Sekretari i Këshilit **Erion Vodo**

Kryetar Komisionit **Beqir Sulovari**

ANALIZA E SONDAZHIT NE LIDHJE ME PRIORITETET E PUBLIKUT PER PROJEKTBUXHETIN AFATMESEM 2024-2026

QELLIMI DHE MBARVAJTJA E SONDAZHIT


Ky sondazh ka si qëllim të mundësojë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje duke mbledhur mendimin e komunitetit mbi mënyrën se si Bashkia ka shpenzuar fondet publike gjatë vitit 2022 si dhe të ndihmojë Këshillin Bashkiak të kuptojë se cilat janë prioritet kryesore të komunitetit në lidhje me buxhetin afatmesëm 2024-2026.
Sondazhi merr mendimin edhe në lidhje me performancën e shërbimeve kryesore si dhe në lidhje me gatishmërinë për të paguar më shumë tarifa për të përmirësuar shërbimet që i ofrohen.
Bazuar në rezultatet e këtij sondazhi, Këshilli Bashkiak Lushnjë ka hartuar një shkresë përcjellëse në lidhje me kërkesat prioritare të komunitetit për shpenzimet buxhetore e cila mendohet të ndihmojë administratën në percaktimin e tavaneve përgatitore.
Pyetjet e sondazhit bazohen në të dhënat faktike të vitit 2022 dhe shpenzimet për shërbimet kryesore gjatë vitit 2023.
Pyetësori është publikuar në Websitin e Bashkisë si dhe në faqet e fcb të Bashkisë dhe të Këshillit në dt 1/02/2023 dhe ka qëndruar online deri më datën 06/03/2023.

REZULTATET E SONDAZHIT

TE DHENA TE PERGJITHSHME

Pjesëmarrja e përgjithshme


Sondazhit i janë përgjigjur 107 persona, nga të cilët rreth 42 persona ose e 39% e tyre janë gra & vajza, ndërsa 65 persona ose 61% e tyre jane **burra dhe d**jem.



Përfaqësimi Rezidencial

Pjesëmarrja sipas rezidencës në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë duke përfshirë edhe ndarjen gjinore meshkuj/femra, është sipas tabelës së mëposhtme:

Rezidenca	Femer	Mashkull	Total
Lushnje	22	26	48
Bubullimë	3	5	8
Hysgjokaj	3	5	8
Golem	2	4	6
Dushk	2	4	6
Karbunarë	2	3	5
Ballagat	1	3	4
Fier Shegan	6	8	14
Kolonjë	3	5	8




Siç mund të vërehet edhe nga tabela e mësipërme, përfaqësimi rezidencial është gjithëpërfshirës, ku vërehet se dominon pjesëmarrja nga qyteti i Lushnjest me rreth 45% të pjesëmarrësve në sondazh, ndërkohë që ka një pjesëmarrje të konsiderueshme edhe nga Njësia Administrative e Fier Shegan me 13%. Njësitë e tjera Administrative kanë një përfaqësim disi më të ulët, por e rëndësishme është që ka përfaqësues nga çdo Nj.A.

Përfaqësimi sipas grup moshave

Vërehet se pjesëmarrësit në sondazh janë sipas të gjitha grupmoshave, ku dominion grup mosha **31 – 45 vjeç me 42%,** e ndjekur nga grup mosha 18-30 vjeç me **36%**. Në sondazh ka një përfaqësim relativiasht të ulët nga personat mbi 60 vjeç (vetëm 5%). Në tabelën dhe grafikun e mëposhtem, paraqitet përfaqësimi sipas grup moshave në numra dhe përqindje.


Grupmosha	Numri
18-30 vjeç	39
31-45 vjeç	45
46-60 vjeç	18
mbi 60 vjeç	5
Totali	107



Përfaqësimi sipas kategorive të punësimit/veprimtarisë në sektorin ekonomik të pjesëmarrësve

Opinioni përmes sondazhit është shprehur nga përfaqësues të aktiviteteve të ndryshme ekonomike, ku kryeson kategoria e të punësuarve në sektorin public (Administratë) me 33% ose 35 persona, e cila pasohet nga kategoria "I punësuar në sektorin privat" me 17% ose 18 persona. Numri më i ulët i pjesëmarrësve vjen nga persona që i përkasin kategorisë "Punonjës OJF/Akademik" dhe "Tjetër", të cilët zënë gjithsej së bashku 8% të totalit të pjesëmarrësve për kategori. Në sondazh duket qartë se kemi një përfaqësim nga të gjitha kategoritë e veprimtarive ekonomike.

Kategoria	Numri i pjesëmarrësve
I vetë punësuar	18
punësuar në sektorin privat	18
I punësuar në sektorin publik (administratë)	35
Punonjës OJF/Akademik	7
Student	10
I papunë	17
Tjetër	2
Totali	107



PRIORITETET E KOMUNITETIT NE LIDHJE ME BUXHETIN 2024

Analizimi i prioriteteve të komunitetit

Sigurisht që aspekti më i rëndësishëm që sondazhi përpiqet të analizojë dhe të marrë mendimin e komunitetit ka të bëjë me **prioritetet e komunitetit**. Për të bërë këtë, merren në analizë funksionet / programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2022 si dhe ato programe për të cilat është shpenzuar më pak se deri në 3% e buxhetit. Qëllimi është të kuptohet se për cilat nga këto funksione komuniteti mendon se duhet të rritet pesha e shpenzimeve në raport me shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë. Ndaj, pjesëmarrësve veç listës së programeve më të financuara, i listohen në sondazh edhe lista e funksioneve/programeve buxhetore të financuara deri në 3% ose që nuk janë financuar nga Bashkia dhe pjesëmarrësit zgjedhin 1 ose më shumë funksione nga kjo listë, duke shprehur në këtë mënyrë opinionin e tyre mbi funksionet që duhet të jenë në fokusin e Bashkisë gjatë vitit 2024 dhe në planin afatmesëm të bashkisë 2024 – 2026. Përgjigjet e pjesëmarrësve janë paraqitur në tabelën përbri.

Sikurse vihet re nga përgjigjet e pyetjes nr. 7, programet më prioritare për komunitetin janë:

"Mbështetje për zhvillimin ekonomik" me 47%,

" Shërbimet bujqësore" me 46%,

"Ujrat e zeza dhe kanalizimet" me 38%

"Transporti Publik" me 36%

"Ndriçim Rrugësh" me 38%

Prioritetet e komunitetit	numri	përqindja
Policia Vendore	11	10.19%
Mbrojta nga zjarri dhe mbrojta civile	13	12.04%
Marredheniet me komunitetin	21	
Mbeshtetje per zhvillimin ekonomik	51	47.22%
Sherbimet e tregjeve dhe inspektimi	27	25.00%
Sherbimet Bujqesore	50	46.30%
Pyjet dhe kullotat	12	11.11%
Transporti publik	39	36.11%
Turizmi	20	18.52%
Ujerat e zeza dhe kanalizimet	41	37.96%
Planifikimi urban vendor	23	21.30%
Programet e Zhvillimit	26	24.07%
Furnizimi me ujë	31	28.70%
Ndricim rrugesh	41	37.96%
Kujdesi paresor shendetesor	34	31.48%
Arsimi I mesëm I pergjithshem	20	18.52%
Arsimi Profesional	20	18.52%
Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuara	26	24.07%
Sigurimi shoqeror	12	11.11%
Kujdesi social per familjet dhe femijet (perfshihet çerdhja)	23	21.30%
Papunesia	71	65.74%
Strehimi	20	18.52%
Other	3	2.78%

Sic edhe mund të vërtetohet nga tabela dhe grafiku I mëposhtëm, shumica e pjesëmarrësve në sondazh janë dakort të paguajnë më shumë taksa për shërbime më cilësore në lidhje me:

"Për kopshtet dhe çerdhet" janë dakort të paguajnë me tepër tarifa 54% e të anketuarve;

"Për menaxhimin e mbetjeve" janë dakort të paguajnë me tepër tarifa 57% e të anketuarve;

" Për furnizimin me uje" janë dakort të paguajnë me tepër tarifa 50% e të anketuarve;

& "Për ndriçimin publik" janë dakort të paguajnë me tepër tarifa 48% e të anketuarve.

Shërbimet publike të ofruara nga Bashkia	Gatishmëria për të paguar me tepër taksa dhe tarifa	E shprehur në përqindje
Për menaxhimin e mbetjeve	61	57%
Për ndriçimin publik	51	48%
Për gjelbërimin, mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave të tjera publike	48	45%
Për furnizimin me ujë	54	50%
Për ujitjen dhe kullimin	47	44%
Për shërbime të tjera (pyjet dhe kullotat, zjarrfikësen, parkimin, përdorimin e hapësirave publike, etj.)	41	38%
Për kopshtet dhe çerdhet	58	54%

